



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

Datë: 16.04.2025
Numër Protokolli: 2831/2025

A.nr.275/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Ylber Fetahaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.275/2025, të datës 05.02.2025, të parashtruar nga ankuesi A.K., kundër organit të punësimit: Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 16.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.275/2025, e datës 05.02.2025, e parashtruar nga ankuesi A. K.

II. Mbetet në fuqi Njoftimi, i datës 21.01.2025 i Menaxherit të Burimeve Njerëzore i Shërbimit Korrektues të Kosovës, lidhur me shpalljen e rezultatit përfundimtar në procedurën e pranimit me numër të referencë: RN00015409, për pozitën e punës „Drejtor i Qendrës së Paraburgimit” ne Peje.

A r s y e t i m

Ankuesi A. K. (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), me datë 05.02.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nën shenjen A.nr.275/2025, kundër konkursit me Nr. Ref: RN00015409, për pozitën e punës „Drejtor i Qendrës së Paraburgimit” ne Peje klasa e pozitës, Drejtues i Mesëm, me mandat 4 vjeçar, i shpallur nga Shërbimi Korrektues i Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 27.02.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa, kjo e fundit, me datë 03.03.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, administroi këto prova: Ankesën me numër protokollit 812/2025 e parashtruar nga ankuesi më datën 05.02.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin për verifikim paraprak i datës 06.12.2025; Njoftimi i datës 21.01.2025 i Menaxherit të Burimeve Njerëzore i Shërbimit Korrektues të Kosovës për shpalljen e rezultatit përfundimtar; Konkursin me Nr. Referencë: RN00015409, pozita e punës Drejtor i Qendrës së Paraburgimit, si shpallur nga Komuna e Prishtinës; Kopjen e ID-së së ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 27.02.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 03.03.2025; listën e aplikativë; njoftimin përmes emali për testin më shkrim; Vendimin e datës 12.12.2024 për themelimin e komisionit të pranimit; renditjen përfundimtar e kandidateve te datës 21.01.2025; Marrëveshjen për transferim te datës 14.10.2024; Akt Emërimit e datës 09.12.2022; vendimin e datës 27.02.2024; Vendimin e datës 23.11.2022; Vendimin e datës 11.12.2023;Akt Emërimit e datës 05.05.2023; Aplikacion e Ankuesit A.K i datës 15.11.2024 te bashkangjitur me dokumentet e aplikimit; Aplikacionin e kandidate fituese A.B me date te aplikimit 18.11.2024 te bashkangjitur me dokumente e aplikimit; Emalin e datës 18.03.2025 te A.K. për sqarimet nga DMZP; testin me shkrim te ankuesit dhe testin me shkrime te kandidates fitues; Kërkesën për sqarim dërguar DMZP te datës 07.04.2025; Emilin nga DMZP te datës 08.04.2025 lidhur me sqarimet e kërkuar nga KPMSHCK; emalin e datës 10.04.2025 te organi punësimi ku kishte bashkangjitur prova shtese;

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e ankuesit, është e pabazuar, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës del se Shërbimi Korrektues i Kosovës më datë 21.10.2024, ka shpallur konkursin me numër reference RN00015409, për pozitën „Drejtor i Qendrës se Paraburgimit në Peje”, klasa Drejtues i Mesëm, me mandat 4 vjeçar, ku afati për aplikim ka qenë nga data 22.10.224 deri më 20.11.2024.

Tutje sipas shkresave të lëndës rezulton së në këtë konkurs kanë aplikuar njëmbëdhjetë (11) kandidatë mesin e tyre edhe ankuesi, ndërsa, në fazën e verifikimit paraprak kanë kaluar vetëm pesë (5) kandidatë, përfshirë ankuesin i cili dhe i është nënshtruar fazës së vlerësimit testit me shkrim, nga e cila fazë vlerësimi ka arritur gjithsej 30.2 pikë, duke mos arritur të marre pikë të mjaftueshme për të vazhduar tutje në fazën e vlerësimit të intervistës me gojë.

Organi përkatës i punësimit, pas përfundimit të procesit të rekrutimit më datë 21.01.2025 ka publikuar listën mbi rezultatet përfundimtare të testit me shkrim dhe intervistë me gojë, sipas së cilës kandidatja A. B. me gjithsej 80.8 pikë të arritura, është shpallur kandidate fituese për pozitën „Drejtor i Qendrës se Paraburgimit në Peje ”

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër rezultateve preliminare të kësaj procedure, pretendon se testi me shkrim që e ka pranuar ne procedurën e testimit në forme elektronikë, ishte ekskluzivisht në gjuhen shqipe ndërsa unë jam përfaqësues i komuniteti boshnjak(anëtar i komunitetit pakicë)dhe nuk me është dhëne mundësia ta kem testin ne gjuhen amtare ose ne gjuhen qe është e ngjashme me gjuhen qe është e garantuar më Kushtetutë në rastin konkret gjuhën serbe, prandaj jam vendosur ne një pozicion të pabarabarta më të tjerët pasi qe kandidatet tjerë e kishin testin në gjuhën e tyre amtare dhe po ashtu i njëjti pretendon se kandidatja e përzgjedhur ne këtë konkurs sipas njoftimit të SIMBNJ e njëjta nuk ishte me datën 06.12.2024 nuk ishte ne listë ndërsa me datën 09.12.2024 është ber njoftimi i ri qe është përfshire edhe kandidatja e njëjte si kandidate qe plotëson kriteret.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i aktit të shpalljes së konkursit më Nr. ref. RN00015409, për pozitën Drejtor i Qendrës së Paraburgimit, si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar: **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor). **Kërkesat specifike:** certifikata licence kur kërkohen me legjislacionet ne fuqi. **Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku pese 5 vite përvojë pune profesionale duke përfshirë kërkesat ; (3) tre vite provoj pune për pozitën drejtues; (2) dy vite provoj pune ne pozitën drejtues dhe diplome nivelit te dyte te arsimit(master) 3.nje (1) vite provoj pune ne pozitën drejtuese dhe diplomën të nivelit të tret t arsimit të lartë (doktoratës).

Ndërsa, në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji iu referuar dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht:

- **Nenit 39 paragrafi 1:** 1.Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj.

- **Nenit 44 :** 1. Pranimi në pozitë të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese bëhet me konkurs të hapur dhe publik të organizuar për çdo pozitë të lirë. 2. Procedura e rekrutimit organizohet nga njësia përgjegjëse për institucionet e administratës shtetërore dhe nga NjMBNj për çdo institucion tjetër shtetëror. 3. Shpallja e procedurës së rekrutimit bëhet nga njësia përgjegjëse, në SIMBNj-së, në ueb faqen e institucionit përkatës, si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit. 4. Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e shpalljes së procedurës së rekrutimit. 5. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 5.1. verifikimi paraprak, përmes së cilit verifikohet nëse kandidatet/ët plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të posaçme, sipas shpalljes së konkursit; dhe 5.2. vlerësimi profesional, që përfshin vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidateve/ëve. 6. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional kryhet nga komisioni i pranimit për pozita të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese. 7. Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë. 8. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është njëqind (100) pikë. 9. Në përfundim të vlerësimit, kandidatja/i i vlerësuar me më së shumti pikë, por jo më pak se shtatë dhjetë për qind (70 %) të pikëve totale të vlerësimit, konsiderohet kandidat fitues. Të gjithë kandidatet/ët njoftohen individualisht me rezultatet e procesit të rekrutimit. Lista e kandidateve/ëve që kanë kaluar pragun prej shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve totale publikohet në SIMBNj-së, si dhe në ueb faqen e institucionit përkatës.

Po ashtu për vendosje të drejtë dhe meritore lidhur me këtë çështje administrative, Kolegji mori për bazë edhe Rregulloren (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, me theks të veçantë:

- **Nenin 7 :** 1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidatët për pranim në shërbimin civil plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga NjMBNj, më së largu pesëmbëdhjetë (15) ditë pas kalimit të afatit për pranimin e aplikacioneve, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit.

- **Nenin 8:** Faza e vlerësimit profesional përbëhet nga testi me shkrim dhe intervista dhe zhvillohet nga Komisioni i Pranimit me mbështetjen e NjMBNj

-Nenin 9 ku përcaktohet se: 1. Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim është hapi i parë i procesit të vlerësimit profesional të kandidatëve pas verifikimit paraprak, dhe duhet të realizohet më së largu 15 ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar verifikimin paraprak. 2. Në testimin me shkrim, kandidatët vlerësohen për njohuritë, aftësitë dhe cilësitë kryesore të domosdoshme, të kërkuara për pozitën apo grupin e pozitës përkatëse. 3. Vlerësimi maksimal i mundshëm për testimin me shkrim është deri në shtatëdhjetë (70) pikë. 4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim. 5. Obligohet ministria përgjegjëse për administratën publikë që brenda një (1) viti nga miratimi i kësaj Rregulloreje, të hartojë një bazë të dhënash me pyetje për testimin me shkrim dhe/apo intervistën me gojë. Deri në krijimin e kësaj baze të dhënash, Komisioni i Pranimi në përbërje të plotë është i obliguar që jo më herët se njëzet e katër (24) orë para mbajtjes së testit, të hartojë pyetjet e testit me shkrim të modelit zgjedhje e shumëfishtë me një përgjigje të saktë, si dhe një ese me shkrim, duke marrë parasysh fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara 3/4 në shpalljen për rekrutim. Pyetjet vendosen në sistemin elektronik nga Komisioni, i cili administron procesin e testimit. 6. Testi me shkrim përmban gjithsej njëzet e pesë (25) pyetje dhe një (1) ese të shkurtër. Secila përgjigje e saktë vlerësohet me dy (2) pikë, ndërsa eseja mund të vlerësohet me më së shumti njëzetë (20) pikë. 7. Kohëzgjatja e testimit me shkrim është jo më shumë se nëntëdhjetë (90) minuta. 8. Anëtarët e Komisionit të Pranimi, vlerësojnë testin me shkrim në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, më së voni në afat prej dhjetë (10) ditësh nga dita e përfundimit të tij. Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë vlerësohen nga sistemi në mënyrë elektronike, ndërsa eseja vlerësohet nga Komisioni i Pranimi. 9. Eseja vlerësohet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimi në mënyrë individuale, të cilët e nënshkruajnë formularin e vlerësimit dhe vendosin pikët në SIMBNJ. Mbledhja e pikëve të secilit anëtar të Komisionit, nxjerr mesataren e vlerësimit përfundimtar për ese nga ana e Komisionit, për një kandidat të caktuar. Shuma e pikëve të vlerësuara nga sistemi dhe pikëve të esesë, përbën vlerësimin përfundimtar të testimit me shkrim. 10. Pas vlerësimit të testimit me shkrim, NjMBNj sipas rekomandimeve të Komisionit të Pranimi e përpilon listën e kandidatëve që e kanë kaluar testimin me shkrim. 11. Lista sipas paragrafit 10 të këtij neni bëhet publike nga NjMBNj në SIMBNj, fagen e institucionit si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit, si dhe nenit 10 paragrafi 9, 10 dhe 11 ku përcaktohet se: 9. Në intervistë kandidati mund të merr më së shumti tridhjetë (30) pikë, ku prej tyre dhjetë (10) pikë janë për jetëshkrimin (CV). 10. Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin ndahet si vijon: 10.1. deri në tre (3) pikë për arsimimin; 10.2. deri në katër (4) pikë për përvojën relevante në punë; dhe 10.3. deri në tre (3) pikë për trajnimet relevante. 11. Vlerësimi përfundimtar i intervistës për një kandidat është mesatarja aritmetike e vlerësimeve e të gjithë anëtarëve.

Po ashtu, në ndërlidhje me pretendimet ankimore të ankuesit, Kolegji mori parasysh edhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.05/2024 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, me theks të veçantë nenin 4 paragrafi ku përcaktohet se: Paragrafi 5 i nenit 9 të Rregullores bazike ndryshohet si në vijim: Obligohet ministria përgjegjëse për administratën publikë që brenda një (1) viti nga miratimi i kësaj Rregulloreje, të hartojë një bazë të dhënash me pyetje për testimin me shkrim dhe/apo intervistën me gojë. Deri në krijimin e kësaj baze të dhënash, Komisioni i Pranimi në përbërje të plotë është i obliguar që jo më herët se njëzet e katër (24) orë para mbajtjes së testit, të hartojë pyetjet e testit me shkrim të modelit zgjedhje e shumëfishtë me një përgjigje të saktë, si dhe një ese me shkrim, duke marrë parasysh fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara në shpalljen për rekrutim. Pyetjet vendosen në sistemin elektronik nga Komisioni, i cili administron procesin e testimit.

Si rrjedhojë, bazuar në kuadrin përkatës ligjor, si dhe shqyrtimi dhe analizimi i provave të lëndës Kolegji ka gjetur se pretendimi ankimor i ankuesit se procedura përkatëse e rekrutimit është zhvilluar në kundërshtim me ligjin material gjegjësisht me përpilimin dhe përmbajtjen e testit me

shkrim , nuk qëndron, ngase Kolegji ka konstatuar se vlerësimi i kandidatëve lidhur me procedurën përkatëse të rekrutimit është realizuar në mënyrë elektronike, gjegjësisht testi me shkrim ka përmbytur njëzet e pesë (25) pyetje dhe një (1) ese, dhe se pyetjet e testit kanë qenë të njëjta për të gjithë kandidatët dhe janë vlerësuar në pajtim me procedurën e përcaktuar me dispozitat e nenit 9 të Rregullores Nr.15/2024 për Pranim dhe Karrierën në Shërbimin Civil dhe Rregullores (QRK) Nr.05/2024 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimin në Shërbimin Civil, ndërsa nga provat e pranuar nga ankuesi, si dhe organi i punësimit, Kolegji nuk ka mundur të vërtetojë pretendimin ankimor të ankuesit se ndonjë kandidatë është favorizuar në këtë procedurë të rekrutimit, apo që ankuesi është trajtuar në mënyrë jo të barabartë, nga fakti se ashtu sikurse kandidati fitues edhe ankuesi i është nënshtruar testit me shkrim, mirëpo ankuesi në testin me shkrim ka arritur t'i mbledh vetëm, (30.2 pikë), nga rrjedh se i njëjti nuk ka arritur t'i marrë pikët e mjaftueshme për të vazhduar me fazën tjetër të vlerësimit, gjegjësisht vlerësimit të intervistës me gojë, derisa kandidatja e përzgjedhur në testin me shkrim ka mbledhur (53.4 pikë) duke arritur kështu pragun e kalueshmërisë sikurse parashihet me dispozitat e Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 9 paragrafi 4 ku përcaktohet se: *4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim*, ashtu që për sa më sipër nuk qëndron pretendimi ankimor i ankuesit se organi përkatës i punësimit në këtë procedurë të rekrutimit nuk e ka marrë për bazë parimin e meritës, ngase sipas shkresave të lëndës rezulton se kandidatja fituese A.B ka kaluar me sukses testin me shkrim (53.4 pikë) dhe intervistën me gojë (27.4 pikë) duke mbledhur kështu gjithsejtë (80.8 pikë) të përgjithshme, dhe si rrjedhojë e njëjta ka fituar të drejtën për emërim për pozitën „Drejtor i Qendrës së Paraburgimit në Peje” sipas konkursit me numër reference RN00015409, në pajtueshmëri me dispozitat e nenit 11 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Ndërsa, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se i njëjti e kishte testin në gjuhën shqipe dhe nuk ju kishte sigurua testi në gjuhën amtare boshnjake apo serbe dhe ishte diskriminuar në raport me të tjerët, Kolegji i Këshillit, ka kërkuar sqarime nga organi i punësimit dhe DMZP ku është organizuar testi me shkrim, ndërsa në sqarimet e ofruar nga organi i punësimit në përgjigje në ankese ku në emalin e datës 18.03.2025 kanë sqaruar se të njëjtit kanë pyetur DMZP-ne se testi me shkrim për pozitën Drejtor në Qendrën e Paraburgimit në Peje me datën 18.12.2024 a ka qenë i ngarkuar në sistem testi në të dy gjuhët, dhe të njëjtit kanë bashkangjitur emalin e dërguar nga DMZP ku këta të fundit e konfirmojnë se citoj „*Ne bazë të shënimeve në bazën e të dhënave, testi në sistem për procedurën me numër RN00015409, ka qenë edhe në gjuhën serbe pra i ka përmbytur edhe pyetjet dhe opsionet në gjuhën serbe*”, Po ashtu Kolegji i Këshillit përmasë emali me datën 07.04.2025 me qëllim të konstatojë drejte gjendjen faktike në lidhje me pretendimet e ankuesit i është drejtuar DMZP-se përmes emalit me pyetjen se për pozitën Drejtor i Qendrës së Paraburgimit në Peje, në momentin e organizimit të testimit me shkrim nga DMZP a ishte i formuluar testi edhe në gjuhën serbe dhe a kishte mundësi kandidatit-ankuesi që të zgjedhte vete testin me shkrim sipas dëshirës së tij. Ndërsa DMZP përmes emalit sqaron se: „*Në bazë të shënimeve në bazën e të dhënave, testi i mbajtur për procedurën e rekrutimit RN00015409 për pozitën Drejtor i Qendrës së Paraburgimit ka qenë në të dy gjuhët, pra në gjuhën shqipe dhe atë serbe. Nëse ju duhet kontenti i pyetjeve në të dy gjuhët, ju lutemi të na njoftoni*”. Andaj Kolegji i Këshillit duke u bazuar në përgjigjen e organit të punësimit dhe përgjigjen e DMZP-se, konstaton se pretendimet e ankuesit lidhur me shkelejen e të drejtës së garatuar me Kushtetutë nenin 5 që ka të bëjë me (Gjuhët) respektivisht mos dhenien e mundësise që testin ta ketë në gjuhën amtare ose në gjuhën që është përafshishtë e ngjashme janë të pabazuara sepse i njëjti ka pasur mundësi ta zgjedh edhe testin me shkrim në gjuhën serbe sepse një gjë të tillë ja kishte ofruar sistemi i

DMZP-së në momentin kur ju kishte nënshtruar testit më shkrim pasi që testi ishte i formuluar në dy gjuhe dhe në atë shqipe dhe në gjuhën serbe.

Rrjedhimisht, mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor të KPMSHCK-së për sigurimin e rregullave dhe parime të shërbimit civil si dhe ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes”*, Kolegji ka analizuar në kuptim të ligjshmërisë veprimet procedurale të ndërmarra në këtë procedurë të pranimi të kontestuar me ankesë, dhe si rrjedhojë Kolegji nga analizimi i kriterëve të përgjithshme formale ka konstatuar se kriteret për pozitën e punës „Drejtor i Qendrës së Paraburgimit”, klasa drejtues i mesëm, janë në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil. Përbërja e Komisionit të Pranimi të themeluar më Vendimin e datës 11.12.2024 të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues, ka qenë në harmoni me kërkesat ligjore të përcaktuara më nenin 45 paragrafi 2 të Nr. 08/L-197 për Zyrat e Publikë.

Në kuptim të parimit të meritokracisë si parim bazë në procedurën për pranim në shërbim civil, Kolegji analizoj edhe dosjen e kandidatës fituese nga dhe konstatoj se e njëjti posedon Diplomën me Nr.638/18 të datës më datë 21.06.2018, të lëshuar nga Kolegji AAB me të cilën dëshmohet se ka përfunduar studimet themelore me datë 01.07.2016 në programin Përkujdesje dhe Mirëqenie e Fëmijëve duke marrë titullin Bachelor në Përkujdesje dhe Mirëqenie e Fëmijëve, po ashtu e njëjta posedon diplomën e datës me numër 714/2021 të datës 07.06.2021 të lëshuar nga Kolegji AAB me të cilën dëshmohet se ka përfunduar studimet master në programin Psikologji Organizative dhe Sociale dhe me 27.05.2021 ka fituar gradën Master i Arteve në Psikologji Organizative dhe Sociale, ndërsa lidhur me përvojën e punës pas diplomimit, e njëjta ka deponuar Vërtetimin e datës 18.11.2024 të lëshuar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës -Qendra Korrektuese Dubrave përmes së cilës dëshmohet se kandidatja fituese A.B ka nga data 04.09.2000 ka filluar punën si Zyrtare korrektues, në Shërbimin Korrektues, ndërsa nga data 15.11.2003 e njëjta ishte emëruar si Mbikëqyrës, kurse nga data 15.04.2010 ishte emëruar si Udhëheqës e Pavijonit deri me datën 18.06.2024 ku me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës ishte caktuar Ushtruese e Detyrës së Drejtorit në qendrën Korrektuese në Lipjan si dhe po ashtu e njëjta ka dorëzuar si dëshmi kontratën e punës së datës 12.04.2018 me të cilën dëshmohet se ishte emëruar Udhëheqës e Pavijonit në Qendrën Korrektuese në Dubrave andaj nisur nga kjo gjendje e fakteve rezulton se kandidatja e shpallur fitues A.B ka plotësuar kriteret e përgjithshme formale të përcaktuara me konkurs, e duke qenë së e njëjta në fazën e vlerësimit profesional ka arritur gjithsej 80.8 pikë të përgjithshme, duke u renditur si kandidatja me më së shumti pikë të mbledhura, atëherë, konsiderohet edhe si kandidate e suksesshëm për këtë procedurë të pranimi, kështu që edhe njësia përgjegjëse në këtë rast Divizioni i Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës ka vepruar në pajtim me nenin 11 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Ndaj, siç u konstatua më sipër, gjegjësisht duke qenë se nuk janë evidentuar shkelje ligjore, Kolegji i Këshillit vlerëson se procedura e pranimi sipas konkursit me numër reference RN00015409, për pozitën Drejtor i Qendrës së Paraburgimit në Pejë e shpallur nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, është zhvilluar në pajtim me Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrat e Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, kështu që, bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, me numër A.nr.275/2025

Ylber Fetahaj

Procesmbajtës

Malsore Gashi Bajraktari

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit A. K.;*
- Udhëheqëses të Njesisë së Birimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe*
- Arkivit të KPMSHCK-së.*